



IEKA

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Raport Vjetor 2020

30 Qershor 2021

Përgatitur nga:
Elida Miti, Sokol Toska

Përgatitur për:
Asamblenë e Përgjithëshme IEKA

Përmbajtja e Lëndës

I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV.....	3
I.i. ORGANET E QEVERISJES.....	3
I.ii. ORGANI MBIKËQYRËS.....	6
I.iii. KOMITETET DHE KËSHILLAT.....	6
II. VEPRIMTARIA FINANCIARE.....	9
II.i. PROCEDURAT KONTABËL.....	10
II.ii. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN.....	12
II.iii. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD.....	17
II.iv. KOMENTE MBI SITUATËN FINANCIARE.....	17
III. KONSTATIME DHE REKOMANDIME.....	18
IV. ORGANIGRAMA IEKA.....	20

I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV

Emri: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Statusi juridik: Organizatë jo fitimprurëse, shoqatë.

Selia: Rruga e Elbasanit, Pall Edil Al-It, kati 3, Tiranë.

Themeluar: Me vendim gjykate nr 3573, datë 16 tetor 1998.

Themeluesit: Grupim profesional i Audituesve Ligjorë dhe Shoqërive të Auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit të audituesve ligjorë në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

I.i. ORGANET E QEVERISJES

Organi më i lartë vendimmarrës. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Organi Drejtues. Këshilli Drejtues i IEKAs përbëhet nga shtatë anëtarë, katër nga të cilët janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2023 dhe tre anëtarët e tjerë të zgjedhur me short të cilët e kanë mandatin nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2021. Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 1 tetor 2019 ka zgjedhur Kryetarin dhe zv/Kryetarin e tij. Struktura e KD paraqitet si vijon:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Zj. Eleonora OLLI	Kryetar	Shtator 2023
Z. Arqile MISHTAKU	Zv/Kryetar	Shtator 2021
Z. Bujar OSMANI	Anëtar	Shtator 2021
Z. Shkëlzen MARGJEKA	Anëtar	Shtator 2021
Z. Berti PASHKO	Anëtar	Shtator 2023
Zj. Rezarta KOÇOLLARI	Anëtar	Shtator 2023
Z. Elton TIRANA	Anëtar	Shtator 2023

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

Për shkak se Znj. Eleonora Olli mori një masë disiplinore nga BMP, me pezullim të ushtrimit të profesionit për periudhën 1 vit, Këshilli Drejtues i mbledhur në datën 16.9.2020 ka vendosur shkarkimin e Znj. Eleonora Olli si Kryetare dhe si Anëtare e Këshillit Drejtues. Më tej, Këshilli Drejtues është mbledhur në datën 9.10.2020 dhe ka vendosur të zëvendësojë Znj. Eleonora Olli me Z. Arian Cyrbja si dhe të zgjedhë si kryetar të Këshillit Drejtues Z. Berti Pashko. Pas këtij vendimi, struktura e Këshillit Drejtues paraqitet si vijon:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Z. Berti PASHKO	Kryetar	Shtator 2023
Z. Arqile MISHTAKU	Zv/Kryetar	Shtator 2021
Z. Bujar OSMANI	Anëtar	Shtator 2021
Z. Shkëlzen MARGJEKA	Anëtar	Shtator 2021
Z. Arian CYRBJA	Anëtar	Shtator 2023
Zj. Rezarta KOÇOLLARI	Anëtar	Shtator 2023
Z. Elton TIRANA	Anëtar	Shtator 2023

Megjithatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 22.4.2021, e ka refuzuar pranimin e kërkesës për depozitim të këtyre vendimeve të Këshillit Drejtues duke i cilësuar vendimet e datës 16.9.2020 dhe të datës 9.10.2020 si *të marra në kundërshtim me Statutin e IEKA-s dhe me ligjin*. Vendimi i Gjykatës i datës 22.4.2021 është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit në datën 11.5.2021 dhe për këtë nuk kemi informacione të mëtejshme për ecurinë e këtij procesi.

Aktualisht duhet të theksojmë se në regjistrin e organizatave pranë Gjykatës, Znj. Eleonora Olli figuron ende si anëtare dhe Kryetare e Këshillit Drejtues të IEKA.

Gjatë vitit 2020 Këshilli Drejtues është mbledhur vetëm 9 herë pasi nuk janë mbajtur mbledhje për muajt Qershor, Korrik dhe Gusht 2020. Kostot e mbledhjeve të Këshillit Drejtues arrijnë shumën 975 000 lekë, ndërsa honoraret e Këshillit Drejtues kanë një vlerë vjetore 3 000 000 lekë.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

Organi Ekzekutiv. Drejtori i zgjedhur dhe miratuar nga Këshilli Drejtues është Znj. Elvira Hoxha sipas vendimit nr. 43 të datës 20.09.2017. Gjithashtu, në kryerjen e aktiviteteve IEKA ka staf administrativ, i cili gjatë periudhës 2020 ka pasur përbërjen si më poshtë:

1. Elvira Hoxha - Drejtor Ekzekutiv
2. Elda Luga - Specialist Edukimi
3. Tedi Ziko - Specialist, Standardet profesionale
4. Sara Shurdhi - Specialist, Standardet profesionale
5. Eralda Kullolli - Sekretare, Arkëtare
6. Valentina Sora - Specialist Edukimi dhe Kualifikimit të Vijueshem
7. Albana Pllaha - Mirëmbajtje (pastrim) të ambjenteve

Shpenzimet për pagat gjatë vitit 2020 ka qenë 7 041 578 Lekë, për stafin ekzekutiv dhe personelin me kohë të plotë, dhe nuk ka pasur personel me kohë të pjesëshme.

Megjithatë, aktualisht ka pasur lëvizje dhe stafi është reduktuar duke u larguar 4 punonjës. Sot struktura paraqitet si vijon:

1. Elvira Hoxha - Drejtor Ekzekutiv
2. Tedi Ziko - Specialist për Finance Kontabilitetin
3. Eniela Agolli - Juriste
4. Albana Pllaha - Mirëmbajtje (pastrim) të ambjenteve
5. Klementina Kuqja - Specialist për Edukimin dhe Kualifikimin e Vijueshem
6. Kejsi Çela - Sekretare, Arkëtare

Kontrolli i Brendshëm. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm (Komiteti i Auditimit), i zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme e datës 30 Shtator 2019, përbëhet nga:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Zj. Elida MITI	Kryetar	Shtator 2023
Z. Sokol TOSKA	Anëtar	Shtator 2023

Organizimi dhe funksionimi i KKB rregullohet nga nenet 8 dhe 9 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe nga nenet 24 dhe 25 të statutit të organizatës IEKA.

Gjatë vitit 2020 ky komitet ka qenë aktiv në periudhën Qershor dhe Korrik 2020 dhe ka konkluduar me raportin vjetor të periudhës së mëparëshme në datën 6 Gusht 2020. Honoraret e komitetit për periudhën 2020 kanë qenë në shumën 200.000 Lekë.

I.ii. ORGANI MBIKËQYRËS

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, organizimi i të cilit është rregulluar mbi bazën e ligjit 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar) si dhe me VKM nr. 786 date 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të BMP”.

Përbërja e këtij bordi është si vijon:

	<u>Pozicioni</u>
Z. Dritan FINO	Kryetar
Zj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Luan ABAZI	Anëtar
Zj. Edlira LUCI	Anëtar
Z. Klement MERSINI	Anëtar

Përbërja e Bordit të Mbikëqyrjes Publike është miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.03.2017. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë.

I.iii. KOMITETET DHE KËSHILLAT

IEKA ushtron të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe statutore dhe krijon komitete të cilat emërohen nga Këshilli Drejtues dhe të organizuara mbi bazën e parashikimeve ligjore dhe statutore. Aktualisht funksionojnë shtatë komitete dhe këshilla, të cilat i përshkruajmë në vijim:

(1) Komiteti i Regjistrimit, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, me Kryetar Z. Bujar Osmani dhe anëtarë, Z. Arjan Cyrbja, Znj. Kesjana Halili, Znj. Leze Abazi, Znj. Elisa Çela, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve

ligjorë për një periudhë katërvjeçare. Organizimi i këtij autoriteti është rregulluar në bazë të nenit 5, 19 dhe 60 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Regjistrimit pranë IEKA, të propozuar nga IEKA dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë 2020 ky komitet është mbledhur 4 herë duke përdorur shumën prej 214 500 lekë nga buxheti i parashikuar.

(2) Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, i cili përbëhet nga 3 anëtarë, me Kryetar Z. Shkëlzen Margjeka dhe anëtarë Znj. Majlinda Maqellari dhe Z. Elton Tirana. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të neneve 12, 14, 55, 57 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2020 ky komitet është mbledhur 4 herë duke përdorur shumën prej 358 000 lekë.

Ky komitet duhet të ripërtërijë anëtarësinë pas ndarjes së parakohëshme nga jeta e anëtares Znj. Majlinda Maqellari.

(3) Komiteti i Kontrollit të Cilësisë, i cili përbëhet nga 4 anëtarë me kryetar Z. Arqile Mishtaku dhe anëtarë Znj. Vera Lala, Z. Erjon Pjetërnikaj dhe Znj. Brunilda Stefa. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12, 38 dhe 39 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, të ndryshuar, nenit 15 të Statutit të IEKA-s si dhe me Rregulloren për Kontrollin e Cilësisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2020 ky komitet nuk është mbledhur dhe nuk ka marrë honorare. Ky komitet nuk ka funksionuar pasi ka qenë në pritje të delegimit nga BMP, të kontrollit të cilësisë për Jo EIP.

(4) Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijnueshëm Profesional, i cili përbëhet nga 4 anëtarë me kryetar Znj. Rezarta Kocollari dhe anëtarë Z. Kledian Kodra, Z. Doranin Agalliu dhe Z. Julian Naqellari. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12 dhe 25 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar dhe të Statutit të

IEKA-s, si dhe me Rregulloren e Edukimit dhe e Zhvillimit të Vijueshëm Profesional, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Gjatë vitit 2020 ky komitet është mbledhur 7 herë duke përdorur shumën prej 278 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(5) Komiteti i Standardeve Profesionale, i cili përbëhet nga 3 anëtarë me kryetar Z. Berti Pashko dhe anëtarë Z. Artan Xhiani dhe Z. Hysen Çela. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, të ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s.

Gjatë vitit 2020 ky komitet ka realizuar 2 mbledhje duke përdorur shumën prej 44 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(6) Këshilli i Botimit të Revistës Kontabilitet & Auditim, i cili përbëhet nga 5 anëtarë me kryetar Z. Berti Pashko dhe anëtarë Z. Orfea Dhuci, Z. Elvira Hoxha, Z. Fatjan Devija dhe Z. Tedi Ziko.

Këshilli nuk është mbledhur dhe nuk ka zhvilluar aktivitete gjatë vitit 2020.

(7) Njësia (Struktura) e Edukimit të Kandidatëve, me Drejtues Z. Hysen Çela dhe dy specialistët e edukimit, Znj. Elda Luga dhe Znj. Valentina Sora. Aktualisht anëtarët Znj. Elda Luga dhe Znj. Valentina Sora janë larguar nga puna.

Pagesat për Drejtuesin e njësisë së Edukimit gjatë vitit 2020 kanë qenë 595 000 lekë. Kjo shumë është përfshirë në zërin 2.3 të buxhetit, Shpenzime për kualifikimin e kandidatëve. Kjo shumë është e miratuar me vendim të Këshillit Drejtues dhe rekomandojmë që honoraret e kësaj njësie të paraqiten në zërin 2.1.2 në buxhet së bashku me honoraret për komitetet e tjera.

II. VEPRIMTARIA FINANCIARE

Veprimtaria e IEKA-s rregullohet si vijon:

- Ligji nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” të ndryshuar me ligjin 47/2016;
- Kuadri ligjor civil dhe ai për Organizatat jo-fitimprurëse;
- Statuti i IEKA-s.

Veprimtaria e IEKA-s konsiston në organizimin e profesionistëve në lidhje me ushtrimin e profesionit në përputhje me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe nderit të anëtarëve të tij, kualifikimin e vijueshëm profesional dhe njohjen me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Sipas Statutit të IEKAs anëtarët e Institutit paguajnë kuota të detyrueshme vjetore për anëtarësinë (neni 29.1 i Statutit).

Për vitin 2019 kuotat janë si më poshtë:

- Kuota fikse në shumën 70 000 lekë për çdo anëtar aktiv në profesion.
- Kuota fikse në shumën 8 000 lekë për çdo anëtar joaktiv në profesion.
- Kuota variabël 0,5% të qarkullimit total deri 8 milionë Lekë dhe 0,3% të qarkullimit total mbi 8 milionë Lekë.

Të ardhurat nga kuotat e ndryshme apo trajnimet e realizuara shërbejnë për të përballuar shpenzimet; për të kryer pagesat e honorareve të Këshillit Drejtues dhe të Komiteteve, kuotat për pjesëmarrje në organizatat ndërkombëtare; për pagat e personelit dhe për mbulimin e kostove të shërbimeve që IEKA merr nga të tretët në kryerjen e veprimtarisë së vet.

Veprimtaria e IEKA-s realizohet nëpërmjet organeve drejtuese dhe ekzekutive. Organet drejtuese funksionojnë mbi bazën e parashkimeve statutore dhe ligjore, ndërsa organet ekzekutive funksionojnë mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Më poshtë po përmendim funksionet e Sektorit të Financë - Kontabilitetit shkurtimisht, meqënëse edhe detyra e KKB fokusohet tek ky sektor.

Sektori i Financë kontabilitetit përbëhet nga vetëm një person, Znj. Valentina Sora dhe detyrat kryesore janë si vijon:

- Përgatit dhe i paraqet Drejtorit ekzekutiv treguesit kryesorë të projekt - buxhetit të Institutit, sipas aktiviteteve për periudha afatmesme dhe afatshkurtëra.
- Llogarit kostot sipas aktiviteteve të Institutit dhe bën regjistrimin e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në librat dhe regjistrat kontabël, në pajtim me politikat dhe bazën kontabël të aplikueshme ose të aprovuar nga Këshilli Drejtues;
- Llogarit pagat e punonjësve dhe shumat e honorareve të miratuara nga Këshilli Drejtues si dhe përgatit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për pagesat që IEKA ju bën të tretëve për shërbimet e përfituara;
- Llogarit masën e tatimit mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për të gjitha pagesat sipas rastit që ju bëhen individëve;
- Përpilon dokumentacionin e pagesave për faturat dhe shërbimet e tjera, për pagesat e tatimeve mbi të ardhurat dhe të sigurimeve shoqërore të punonjësve të IEKA-s; etj., të ngjashme;
- Përgatit raportet financiare mujore e tremujore dhe bën analizat përkatëse, të cilat ja paraqet Drejtorit Ekzekutiv;
- Përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe propozon përmirësime në politikat kontabël të përdorura apo në formatet e raportimit në varësi me nevojat e drejtimit dhe të ndara sipas aktiviteteve ku merr pjesë Instituti;
- Informon vazhdimisht për gjendjen financiare të Institutit Drejtorin Ekzekutiv dhe Kryetarin e Këshillit Drejtues të Institutit;
- Kontrollon gjendjen fizike të arkës dhe regjistrimet e bëra në librin e saj, verifikon gjendjen fizike të aktiveve afatgjata e afatshkurtëra dhe përgatit dokumentacionin ku regjistrohen të gjitha transaksionet apo regjistrimet kontabël që ndikojnë në këto aktive, jo më pak se një herë në muaj;
- Bën rakordimin e kontributeve me detyrimet e anëtarëve duke u bazuar në të dhënat e kontabilitetit dhe të dhënat e vetë deklarimeve të bëra prej tyre.

II.i. PROCEDURAT KONTABËL

Organi Ekzekutiv i IEKA-s ka ndërtuar sistemin e regjistrimeve në kontabilitet, sipas parimeve dhe metodave të njohura kontabël, të cilat janë në përshtatje me Ligjin “Për Kontabilitetin” si dhe në funksion të dhënies së informacioneve mbi realizimin e zërave të parashikuara në buxhetin e miratuar.

Kryerja e shpenzimeve realizohet mbi bazën e domosdoshmërisë së tij, me qëllimin e përdorimit sa më me efektivitet të burimeve.

Çdo shpenzim shoqërohet me dokumentacion bazë justifikues, autorizohet dhe miratohet nga personat përgjegjës.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

Drejtori Ekzekutiv autorizon shpenzimet e buxhetuara si dhe veprimet që lidhen me pagesat apo tërheqjet nga llogaritë bankare të IEKA-s, brenda kufijve të përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

Blerjet me lekë në dorë verifikohen nga Specialisti i Financës dhe paguhen nga Arkëtari dhe në çdo rast kanë tre firma, përfshirë nënshkrimin nga Drejtori Ekzekutiv.

Organet ekzekutive planifikojnë që në fillim të vitit paraardhës buxhetin për blerjen e çdo lloj pajisje, materiali apo shërbimi. Janë zbatuar metodikat e llogaritjes së kostove sipas aktiviteteve të institutit, sic janë edukimi profesional hyrës dhe i vijueshëm, publikimet, etj.

Specialisti i Financës ndjek arkëtimin e kuotave fikse dhe variabël të anëtarëve, kuotave të kandidatëve si edhe të të ardhurave të tjera si kurse trajnimi, regjistrime të reja, botime, e të tjera.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

II.ii. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar realizimi i buxhetit për vitin paraardhës, Buxheti i planifikuar për vitin 2020 dhe realizimi i tij në vlerë absolute dhe në përqindje përkundrejt buxhetit të planifikuar.

Zerat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 12M 2019	Buxheti i miratuar 2020	Realizimi Buxhetit 12M 2020	% ndajBuxhetit
1 Burimet	30,834,133	27,250,000	31,965,296	117%
1.1 Burime financiare	27,913,999	24,200,000	28,339,058	117%
Kuota fikse e anetaresimit	15,010,558	14,700,000	16,062,867	109%
Kuota variable e misionëve	8,331,243	7,000,000	8,286,119	118%
Te ardhura nga regjistrimi kandidatëve	2,850,000	1,500,000	2,550,000	170%
Te ardhura të tjera	1,722,198	1,000,000	1,440,072	144%
1.2 Burime të ardhurash të tjera	2,920,134	3,050,000	3,626,238	119%
Burime (teardhura) nga Botimet	19,800	150,000	3,400	2%
Burime (teardhura) kualifikime kandidatë	790,500	1,500,000	2,910,000	194%
Burime (teardhura) nga kualifikimi AL	122,000	200,000	410,000	205%
Burime nga trajnimi i SKK/SNK	1,532,000	1,000,000	0	0%
Te ardhura nga depozitat e kursimeve	445,694	200,000	295,733	148%
Fitime/humbje kursi kembimit	10,140	0	7,105	0%
2 Perdorime (Shpenzime)	29,934,594	33,022,000	23,530,182	71%
2.1 Shpenzime nga veprimtaria	21,936,927	27,522,000	20,448,864	74%
2.1.1 Pagat e punonjësve	6,243,762	9,336,000	7,041,578	75%
Pagat e personelit me kohetëplotë	4,984,706	8,000,000	6,172,658	77%
Sigurime shoqërore	683,056	1,336,000	868,920	65%
Pagat personeli me kohepjesshme	576,000	0	0	0%
2.1.2 Honoraret e Drejtimit	4,215,000	4,496,000	4,175,000	93%
Honorare Ant KD & Drejtimi përditshëm	3,000,000	3,000,000	3,000,000	100%
Pagese për mbledhje të KD	1,035,000	1,296,000	975,000	75%
Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	180,000	200,000	200,000	100%

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

Zerat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 12M 2019	Buxheti i miratuar 2020	Realizimi Buxhetit 12M 2020	% ndajBuxhetit
2.1.3 Honorare per Komitete	963,760	1,550,000	894,500	58%
Komiteti i Regjistrimit	381,000	350,000	214,500	61%
Komiteti i Investigimit&Disiplines	188,000	360,000	358,000	99%
Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit te Vjueshem	201,000	300,000	278,000	93%
Komiteti i Kontrollit te Cilesise	0	200,000	0	0%
Komiteti perkthim rishikim te Stand. Prof	149,760	240,000	0	0%
Komiteti i Etikes, Standardeve Profesionale & te tjera	44,000	100,000	44,000	44%
2.1.4 Shpenzimet e Administrimit	8,952,865	10,740,000	7,737,924	72%
Telefon, Fax, shpenzime interneti	190,418	250,000	162,901	65%
Mirembajtja e regjistrit publik&faqes inter.	99,600	100,000	104,600	105%
Energji, Uje.	218,928	200,000	255,978	128%
Kancelari, Shtypshkrime,riparime	199,860	300,000	158,637	53%
Reklama, Publicitet, Njoftime	0	50,000	0	0%
Abonime, Gazeta, revista	0	50,000	0	0%
Udhetime e Djeta	1,880,583	2,200,000	219,992	10%
Karburant e rip. tezakonshme	210,360	300,000	288,200	96%
Taksa, sigurime e parkimautomjetesh	168,781	250,000	166,872	67%
Shpenzime pritjeje	91,228	250,000	133,052	53%
Sherbime ne tetrete	251,996	250,000	230,621	92%
Regjistrime ne organet lokale	126,947	240,000	129,092	54%
Shpenzime per kom. Bankare	97,090	100,000	96,289	96%
Kuota anetaresimi Org. Nd/kombetare	1,787,618	2,100,000	1,524,090	73%
Shpenzimetetjera	338,705	400,000	407,140	102%
Shpenzime per Asamblene	800,849	1,000,000	20,665	2%
Auditimii PF	210,000	200,000	210,000	105%
Shpenzime amortizimi	2,039,902	2,200,000	1,954,163	89%
Shpenzime Konsulence ligjore	240,000	300,000	1,675,632	559%
2.1.5 Investime, Meremetime	1,261,540	1,400,000	599,862	43%
Investime (blerje AAM dhe meremetime)	1,261,540	1,400,000	599,862	43%
Blerje AAGj (pajisje informatike)				
2.1.6 Rezerve e KD gjithsej	300,000	0	0	0%

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2020

Zerat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 12M 2019	Buxheti i miratuar 2020	Realizimi Buxhetit 12M 2020	% ndaj Buxhetit
2.2 Shpenzime per botime	408,576	2,200,000	82,877	4%
Botimi i Revistes	70,400	0	0	
Shpenzime per botime te tjera (SNA dhe te ngjashme)	338,176	700,000	82,877	12%
Tekstet Kaplan te ACCA	0	1,500,000	0	0%
2.3 Shpenzime per kualifikimin	3,389,486	3,300,000	2,996,446	91%
Shpenzime kualifikimi kandidate	1,656,010	1,400,000	2,453,866	175%
Shpenzime kualifikimi AL	942,132	1,300,000	542,580	42%
Shpenzime trajnimi I SKK/SNK	791,344	600,000	0	0%
2.4 Fitime/humbje kursi kembimit	31,989	0	1,995	
2.5 Aktiviteti sipas vendimit Asamblese	4,167,616	0	0	
3.1 Teprica nga veprimtaria kryesore	5,977,072	-3,322,000	7,890,194	
3.2 Teprica nga Publikimet	-388,776	-2,050,000	-79,477	
3.3 Teprica nga kualifikimi AL & Kandidatë	-944,986	-600,000	323,554	
3.4 Teprica nga depozitat e kursimeve	445,694	200,000	295,733	
3.5 Teprica nga kursi i këmbimit	-21,849	0	5,110	
Teprica total	2,161,079	-4,372,000	9,034,976	
Korrigjime per investimet qe nuk jane regjistruar ne shpenzime	166,541	0	0	
Teprica total e korrigjuar	2,327,620	-4,372,000	9,034,976	
Teprica përfshirë Investimin AAM	1,066,080	-5,772,000	8,435,114	
Shpenzimepërtarifen 7% për BMP	2,158,389	1,309,000	2,237,571	
Teprica përfshirë Tarifën7%	-1,092,309	-7,081,000	6,197,543	

(1) Komente të përgjithshme mbi strukturën dhe analizën e buxhetit.

Në analizën e buxhetit do të bëhet një krahasim në vlerë absolute dhe në përqindje midis buxhetit të realizuar për periudhën 2020 me buxhetin e planifikuar dhe të miratuar nga Asambleja për këtë periudhë si dhe me buxhetin e realizuar në periudhën paraardhëse 2019. Në tërësi të kihet në konsideratë efektet e vitit pandemik, ku një sërë aktiviteteesh nuk kanë qenë të mundura të realizohen fare apo të realizohen online dhe jo sipas planifikimit.

(2) Komente mbi Burimet.

Sikurse vihet re, Burimet financiare nga aktiviteti janë realizuar krahasimisht me parashikimin në masën 117%. Kanë ndikuar ndjeshëm në këtë rritje Të ardhura nga regjistrimi kandidateve, të cilat janë realizuar në masën 170% si dhe Te ardhura te tjera, të cilat janë realizuar në masën 144%. Të ardhurat nga regjistrimi kandidateve janë rritur kryesisht sepse është rritur tarifa e regjistrimit e cila aktualisht është 75 000 lekë, kurse rritja në Të ardhura te tjera pavarësisht rritjes së lartë në përqindje nuk ka ndonjë efekt thelbësor në vlerën absolute. Kuota fikse e anëtarësimit dhe Kuota varibël sipas misioneve janë rritur përkatësisht në masën 109% dhe 118%.

Nga Burime te ardhurash te tjera ka një rritje në nivelin 119%. Në këtë rritje ka ndikuar ndjeshëm rritja në Të ardhura nga kualifikimet e kandidatëve dhe AL-ve, ne nivel prej rreth 200% por ka një mosrealizim total të Të ardhurave nga trajnimet SKK/SNK.

Në konkluzion të komenteve mbi Burimet, vërehet një tejkalim i realizimit të të ardhurave të IEKA-s, sidomos në të ardhurat e mbledhura nga anëtarësia nëpërmjet kuotës fikse, e cila ka ardhur si pasojë e shtimit të numrit të anëtarësisë.

Si një përmbledhje e kësaj analize, vërehet:

- **Realizim të të Ardhurave në 104%, krahasuar me 2019**
- **Realizim të të Ardhurave në 117%, krahasuar me buxhetin e planifikuar**

(3) Komente mbi Përdorimet.

Shpenzimet totale janë realizuar në krahasim me planifikimin në nivelin 71%. Kjo tregon një pamundësi në kryerjen e funksioneve dhe aktiviteteve të planifikuara, çka vjen në radhë të parë nga viti pandemik, por nuk duhet lënë pa përmendur edhe problematika që u shkaktua nga shkarkimi i Kryetares së Këshillit Drejtues dhe mënyrës se si vetë Këshilli Drejtues vijoi të administrojë situatën e krijuar.

Ndërsa, nëse analizojmë një nga një zërat e shpenzimeve, konstatojmë si vijon.

Kemi një realizim prej 74% të fondit të pagave, që tregon se nuk është punuar sic duhet me rekrutimin dhe për këtë jemi shprehur edhe në paragrafin I.i në faqen 5 të këtij raporti.

Kemi një realizim në masën 58% të honorareve të Komiteteve që tregojnë një apati në funksionimin e tyre, ku Komiteti i Kontrollit të Cilësisë dhe Komiteti i Standarteve Profesionale nuk kanë funksionuar fare.

Realizimi i Shpenzimeve të administrimit paraqitet në masën 74%, i Investimeve në masën 43% dhe Shpenzimet për botime në masën 4%, cka e përforcon idenë e shprehur në komentet e bëra më sipër.

Gjithashtu, konstatohet një shpenzim në masën 1 675 632 Lekë si shpenzime konsulencë ligjore e cila nuk ishte e parashikuar në buxhetin e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, por megjithatë është e miratuar me vendim të Këshillit Drejtues. Gjithashtu, Këshilli Drejtues ka vendosur që rezervën e KD të miratuar në projekt buxhet, ta kalojë për të mbuluar pjesërisht këto shpenzime për konsulencë ligjore.

Lidhur me shpenzimin për konsulencë ligjore, sqarojmë se ky shpenzim është bërë kryesisht për analizimin dhe kundërshtimin në Gjykatën e Apelit Administrativ për rregulloret e miratuara nga BMP. Aktualisht, mbështetur në marrëveshjen e datës 11.02.2021 midis IEKA dhe BMP, IEKA është angazhuar të tërhiqet nga proceset gjyqësore.

Pra, si një përmbledhje e kësaj analize, vërehet:

- **Realizim të Shpenzimeve në 78%, krahasuar me 2019**
- **Realizim të Shpenzimeve në 71%, krahasuar me buxhetin e planifikuar (përfshirë vlerën e amortizimit)**
- **Një mosrealizim i buxhetit për shpenzimet e pagave, që mendojmë se përbën një problem në vijimësi për IEKA-n.**
- **Një mosrealizim i buxhetit të komiteteve, kryesisht për shkak të mungesës së aktivitetit të tyre, si dhe**
- **Mosrealizim i buxhetit të botimeve.**

II.iii. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD

Pasqyrat financiare të vitit 2020, të evidentuara më 31.12.2020 janë hartuar nga specialisti i Financës Tedi Ziko dhe janë autorizuar nga Drejtori Ekzekutiv Elvira Hoxha. Pasqyrat financiare janë audituar nga Auditues Ligjor TPA Albania sh.p.k. me partner të auditimit Znj. Laura Gjinali në bashkëpunim me Auditues Ligjor, Znj. Rajmonda Reveli, të cilët arritën në datën 28 Maj 2021 në opinionin e pakualifikuar. Lidhur me këtë duam të komentojmë si vijon.

Audituesit e pasqyrave financiare janë emëruar nga Asambleja e Përgjithëshme e Anëtarëve për auditimin e pasqyrave financiare 2018, sic parashikon statuti. Në vijim, për periudhat 2019 dhe 2020, nuk ka pasur emërim sipas parashikimeve statutore, por Këshilli i Drejtimit ka bërë emërimin e audituesit ligjor nëpërmjet vendimit të datës 2.9.2019.

II.iv. KOMENTE MBI SITUATËN FINANCIARE

Sikurse mund të shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit të pasqyrave financiare, Aktivët të evidentuara arrijnë vlerën 123 335 286 Lekë (2019: 119 446 787 Lekë). Detyrimet në datën e bilancit janë 7 045 303 Lekë (2019: 9 354 346 Lekë), dhe Aktivët Neto të IEKA-s kanë vlerën 116 289 983 Lekë (2019: 110 092 441 Lekë).

Ka vend për tu komentuar ulja e detyrimeve, ku pjesën më të madhe, në vlerën 2,24 milionë Lekë, e përbën detyrimi ndaj BMP për tarifën 7%; si dhe një rritje e të drejtave për arkëtim nga anëtarësia, të cilat janë shlyer gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2021.

Sikurse mund të shihet edhe në Pasqyrën e Burimit të Fondeve të pasqyrave financiare, Burimet e evidentuara kanë vlerën 31 662 458 Lekë (2019: 30 378 299 Lekë), përdorimet paraqiten në vlerën 25 765 759 Lekë (2019: 27 726 837 Lekë) dhe Deficiti Neto paraqitet pozitiv në vlerën 6 197 542 Lekë (2019: - 1 092 309 Lekë).

Duke pasur në konsideratë parimet e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe pasqyrës së buxhetit, arrihet në konkluzionin se paraqitjet në Pasqyrën e Aktiveteve të pasqyrave financiare 2020 përputhen me paraqitjet në Pasqyrën e Buxhetit faktik të periudhës 2020.

III. KONSTATIME DHE REKOMANDIME

- 1. Çështja e emërimit të Kryetarit të Këshillin Drejtues:** Sikurse jemi shprehur në raport, IEKA gjendet në pozitën ku formalisht është zgjedhur Kryetar i Këshillit Drejtues Z. Berti Pashko që në muajin Tetor 2020, por ky vendim nuk është regjistruar ende në gjykatë.
- 2. Çështja e emërimit të Audituesve të pasqyrave Financiare:** Lidhur me emërimin e audituesve të pasqyrave financiare rekomandojmë të tregohet seriozitet dhe të emërohen sipas parashikimeve statutores. Kjo i jep vlerën e duhur procesit të auditimit.
- 3. Çështja e Komiteteve:** Duke gjykuar mbi buxhetin e shpenzuar por edhe mbi numrin e mbledhjeve të mbajtura dhe çështjeve të trajtuara, konstatohet se komitetet e krijuara sipas parashikimeve statutores nuk kanë realizuar të gjithë shumën e parashikuar në buxhet për funksionimin e tyre në ndihmë të përmbushjes së objektit të aktivitetit të IEKA-s.

Kështu, në këtë kuadër mund të përmendim mosfunksionimin prej disa vitesh të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë. Duke qenë të vetëdijshëm, nga njëra anë, për rritjen e rolit të BMP në këtë aspekt, dhe, nga ana tjetër, për vështirësitë e krijuara nga viti pandemik, ne vlerësojmë që IEKA duhet të vazhdojë përpjekjet për të kryer funksionin për kontrollin e cilësisë për njësitë jo me interes publik (JO-EIP), duke qenë se ka punuar dhe ka investuar ndër vite, dhe e ka eksperiencën, metodologjinë dhe kapacitetet e duhura për këtë qëllim.

Lidhur me komitetet e tjera, rekomandojmë të jenë më aktivë në realizimin e detyrimeve të tyre bazuar në rregulloret e funksionimit.

- 4. Çështja e botimeve:** Botimet janë mjaft të rëndësishme për edukimin e anëtarësisë por edhe për reputacionin dhe pozitën e IEKA-s në ambjentin sfidues që është krijuar aktualisht. Për këtë arsye gjykojmë se është mjaft e rëndësishme të punohet më mirë dhe më shumë me qëllim nxjerrjen në botim të revistës të paktën 4 numra në vit. Gjithashtu, të punohet më shumë për botimin e të gjitha materialeve që publikohen nga IFAC dhe bordet e tjera të tij që kanë lidhje me profesionin, të cilat aktualisht janë dërguar në mënyrë elektronike.
- 5. Çështja e Debitorëve:** U konstatua se, në vijimësi, ka Debitorë (anëtarë të IEKA-s) që nuk kanë likuiduar detyrimet e tyre.

Detyrimi për kuotën fikse dhe penalitetet paraqitet në zërin llogari të arkëtueshme. Ky zë ka rritje të detyrimit për AL me rreth 800 mijë lekë (2020: 4 203 770 lekë dhe 2019: 3 413 513 lekë) dhe është thujse i pandryshuar detyrimi i papaguar nga AL pasivë (2020: 1 704 750 lekë dhe 2019: 1 750 915 lekë). Aktualisht, në datën e këtij raporti, detyrimet për kuotën fikse nga AL pasive nuk kanë ndryshuar ndërsa detyrimi për kuotën fikse dhe penalitetet nga AL aktive ka arritur në rreth **7 000 000 lekë**. Kjo shume përfshin edhe detyrimet e papaguara nga AL të kuotes fikse të vitit 2021.

Detyrimi për kuotën variabël, krahasimisht me vitin 2019, është rritur për 748 774 lekë (2020: 8 368 781 lekë, ndërsa 2019: 7 620 007 lekë). Duhet patur në konsideratë se regjistrimi i kuotës variabël bëhet mbi bazën e konstatimit dhe si pasojë arkëtimi i kuotës

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)


Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2020

variabël që paraqitet në pasqyrat financiare bëhet gjatë vitit vijues. Aktualisht, në datën 31.05.2021, shuma e kuotës variabël e paarkëtuar është **2 662 829 lekë**.

Mendojmë se çdo anëtar i Institutit duhet të kryejë likujdimin e detyrimeve në pajtim me parashikimet statutores. Ndaj, sugjerojmë që lista e anëtarëve, me mbi dy vjet detyrime të papaguara, të përmenden me emër në Asamble.

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM


Elida MITI
Kryetar


Sokol TOSKA
Anëtar



Tiranë më, 30 Qershor 2021

IV. ORGANIGRAMA IEKA

